

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, në lëndën penale kundër të akuzuarit I. Z. nga Gj, për shkak të veprës penale **Posedimi i Paautorizuar i Narkotikëve, Substancave Psikotrope ose Analoge, nga neni 275, par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së**, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm, PP. II. nr.1820/2015, të datës 20.10.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 22.11.2017, mori dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli, ndërsa, më dt. 30.11.2017, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari I. Z, nga i ati Z dhe nëna F, e lindur Ri, i lindur me datë ..në Gj, ku edhe jeton, në rr...., i martuar, punon në Austri, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, më datën 30.09.2015, në rrugënpa autorizim ka poseduar dhe poseduar narkotikë të llojit "...", në peshë prej..., të cilën e kishte pasur të mbështjellë në letër vezulluese të cigareve në dorë dhe me të takuar policët e antidrogës, e ka gjuajtur në tokë dhe kur është ndalur nga zyrtarët e autorizuar policorë, është kontrolluar fizikisht, me ç'rast nuk i është gjetur asgjë e dyshimtë, por, kur e kanë kontrolluar vendin ku është gjuajtur letra, e kanë gjetur paketimin në fjalë, e cila, pas testit fushor, ka rezultuar se është narkotik i llojit "... " dhe është konfiskuar nga policia,

- me çka ka kryer veprën penale **Posedimi Paautorizuar i Narkotikëve, Substancave Psikotropike, ose analoge, nga neni 275, par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së**, andaj, bazuar dispozitat e neneve 7,17,21,51,69, 73,114, të KPRK-së, dhe nenit 365, 453 të KPPRK-ës.

E G J Y K O N

Me **Dënim Gjore**, në shumën prej **200 (dyqind) €**, të cilën gjobë i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën Gjykata do t'ia zëvendësojë edhe gjobën me dënim burgu, ashtu që do të i llogaritet shuma prej 20 € për një ditë burgimi.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej **20 (njëzet) €**, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 275, par. 3, lidhur me nenin 62. 2.7 të KPRK-së, të akuzuarit i konfiskohet sasia prej 0.5 gr. substancë narkotike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr.1820/2015, të datës 20.10.2015, kundër të akuzuarit I. Z nga Gj, për shkak të veprës penale, **Posedimi Paautorizuar i Narkotikëve, Substancave Psikotropike ose Analoge, nga neni 275, par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së**, dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

Prokurorja e Prokurorisë Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm, Rozelida Manastiri, në fjalën përfundimtare deklaroi se pas seancës së sotme të shqyrtimit fillestar, duke u nisur nga fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe se këtë pranim e ka bërë

edhe pas njoftimit nga ana e gjykatës për pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë, i cili pranim është i mbështetur edhe në provat e tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, fakte këto të pamohueshme që argumentojnë dhe vërtetojnë se i akuzuari është kryes i veprës penale, dhe atë, në tërësi siç është e përshkruar në aktakuzë, andaj, mbeti në tërësi pranë aktit akuzues dhe kërkoi nga Gjykata që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, ndërsa, përkitazi me caktimin e llojit dhe lartësisë dënimit, i propozoi gjykatës që të marrë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, me qëllim që dënimi të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale. Gjithashtu, në bazë të nenit 275, par. 3, lidhur me nenin 62, pika 2.7 të KPRK-së, i propozoi gjykatës që sasia prej 0.5 gr. substancë narkotike e llojit “...” të konfiskohet.

I akuzuari , në fund të procedurës deklaroi se është penduar për këtë veprë penale, i premtonte gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, andaj, luti Gjykatën që t’ia shqiptojë një dënim sa më të butë që është e mundur.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se i akuzuari e ka kryer veprën penale Posedimi i Paautorizuar i Narkotikëve, Substancave Psikotrope ose analoge, nga neni 275, par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, si dhe faktin se për herë të parë është ndeshur me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese, mori shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 1085/15, më datë 30.11.2017

Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë, përmes kësaj Gjykate.